



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

PROTOKOLL

**PËR FUNKSIONIMIN E QENDRAVE REZIDENCIALE
PUBLIKE DHE JO PUBLIKE
QË OFROJNË SHËRMBIMIN E STREHIMIT (STREHËZAT)
PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE TRAFIKIMIT**

NË SITUATËN E PANDEMISË SË COVID-19

Prill, 2020

HYRJE

“Protokolli për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jo-publike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së COVID-19” (këtu e në vijim “Protokolli i emergjencës COVID-19 për strehëzat”), u përgatit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), me mbështetjen e Zyrës së UN Women në Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë.

Duke qenë se eksperiencia botërore paraqet fakte të mundësisë së rritjes apo përshkallëzimit të dhunës në familje në kushte të distancimit social dhe izolimit të detyruar, si dhe nisur nga disa raste të incidenteve të dhunës në familje të ndodhura gjatë muajit mars 2020 në situatën e emergjencës së COVID-19, përgatitja e një protokollit të tillë mori përparësinë e duhur.

Specialistet¹ e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Aftësisë së Kufizuar dhe Ndhmës Ekonomike², Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale³, Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Shërbimeve Sociale⁴, si dhe të Shërbimit Social Shtetëror⁵, të udhëhequra nga Drejtoresha⁶ e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim dhe me ekspertin⁷ e UN Women, e bazuan hartimin e “Protokollit të emergjencës COVID-19 për strehëzat” në Vendimet e Këshillit të Ministrave, Aktet Normative, Udhëzimet apo Urdhërat e miratuara deri tani, për të përballuar situatën lidhur me COVID-19⁸. Përpara miratimit, “Protokolli i emergjencës COVID-19 për strehëzat” u konsultua edhe me organizatat e shoqërisë civile anëtare të Rrjetit Shqiptar për Fuqizimin e Grave (AWEN) dhe Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti-Trafik, si dhe me UN Women, UNFPA dhe UNDP.

“Protokolli i emergjencës COVID-19 për strehëzat” është i vlefshëm vetëm në kushtet e emergjencës së COVID-19 (por mund të përdoret si referencë në kushte të emergjencave të ngjashme të sëmundjeve infektive e pandemive, duke përditësuar pjesë të caktuara të tij në varësi të llojit të sëmundjes dhe masave përkatëse që do ndërmerren nga shteti për përballimin e saj). Ai nuk shfuqizon standardet dhe procedurat e funksionimit të qendrave rezidenciale publike e jo-publike që ofrojnë shërbime të specializuara të strehimit për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit, zbatimin e të cilave mbetet i detyrueshëm në situatë jo-emergjence.

Zbatimi i “Protokollit të emergjencës COVID-19” hyn në fuqi menjëherë pas miratimit dhe ndërpritet kur situata e emergjencës në lidhje me pandeminë e COVID-19 të deklarohet “e përfunduar” nga Qeveria e Shqipërisë.

¹ Znj. Brunilda Dervishaj, Shefe sektori dhe znj. Irena Benusi, Specialiste

² Znj. Eneida Capo, Shefe sektori

³ Znj. Flutra Beqo, Drejtore

⁴ Znj. Xhilda Papajani, Shefe Sektori

⁵ Znj. Luneda Sufali, Drejtore

⁶ Znj. Merita Xhafaj, Drejtore e Përgjithshme

⁷ Znj. Monika Kocaqi, Eksperte për barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje

⁸ Një listë e plotë e tyre paraqitet në Aneksin 1 të këtij Protokollit

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	2
1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT	4
2. COVID-19: ÇFARË DUHET TË DIMË?	4
3. SI DUHET TË VEPROHET PËR PËRBALLIMIN E NJË PANDEMIE	5
3.1. RREGULLAT E PËRGJITHSHME	5
3.2. HAPAT QË DO TË NDIQEN NËSE NJË PËRFITUESE SHFAQ SIMPTOMA TË INFEKTIMIT TË MUNDSHËM ME COVID-19	8
3.3. HAPAT SPECIFIKË TË MENAXHIMIT TË SITUATËS	10
3.4. HAPAT QË DUHET TË NDIQEN PËR PRANIMIN E NJË PERSONI TË RI NË STREHËZ.....	15
4. STANDARDET E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË STREHIMIT, NË KUSHTET E PANDEMISË SË COVID-19	16
5. ANEKSE	27
5.1. BAZA LIGJORE.....	27
5.2. NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 TEK DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ GRAVE	27
6. REFERENCA	32

1. QËLLIMI I PROTOKOLLIT

“Protokolli për funksionimin e qendrave rezidenciale publike dhe jo-publike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së COVID-19” (këtu e në vijim “Protokolli i emergjencës COVID-19 për strehëzat”), synon t’u vijë në ndihmë ofruesve të këtij shërbimi për të funksionuar sa më efektivisht në përputhje me kufizimet për shkak të masave parandaluese. Zbatimi i “Protokollit të emergjencës COVID-19 për strehëzat”, i ndihmon punonjëset e strehëzave, për të ofruar shërbimin e nevojshëm për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit pa çenuar shëndetin dhe jetën e tyre apo të viktimave përfituese të shërbimit, familjarëve dhe komunitet në tërësi.

Në 11 mars 2020 COVID-19 u deklarua nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) si pandemi globale, ndërsa në 24 mars 2020 Qeveria e Shqipërisë shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 243/2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”. Ndonëse në këtë situatë masat parandaluese synojnë distancimin social, izolimin dhe të punuarit kryesisht nga shtëpia, është shumë e rëndësishme që shërbimet mbështetëse të specializuara që ofrohen nga qendrat rezidenciale publike dhe jo-publike për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit (sidomos strehëzat) të mos mbyllen. Kjo gjë dikton nevojën e marrjes së masave shtesë të aplikueshme për funksionimin e tyre, vetëm për periudhën e emergjencës, për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit.

Me mbërritjen e COVID-19, Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë një sërë masash kufizuese për të parandaluar përhapjen e tij në masë në komunitet. Distancimi social dhe izolimi kanë përfshirë dhe kufizimin e një tërësi shërbimesh në komunitet. POR, natyra e problemit të dhunës në familje dhe trafikimit, respektimi i parimit të mosdiskriminimit të përfitueses/it të shërbimeve të strehimit emergjent as për shkaqe shëndetësore⁹, si dhe faktet botërore të rritjes së frekuencës së formave të ndryshme të dhunës ndaj grave në kushtet e masave të ndërmarra¹⁰, diktojnë nevojën e mbajtjes hapur të qendrave rezidenciale që ofrojnë shërbimin e specializuar të strehimit, për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit. Në mënyrë që kjo të ndodhë, si personeli ashtu edhe personat që marrin shërbime në këto strehëza, duhet të mbahen të shëndetshëm.

Prandaj është shumë e rëndësishme që të reagohet ndaj kësaj situatë bazuar vetëm në informacion të saktë dhe nga burime të besueshme, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në <https://shendetesia.gov.al/> dhe Instituti i Shëndetit Publik në <http://www.ishp.gov.al/>

2. COVID-19: ÇFARË DUHET TË DIMË?

Koronaviruset (CoV) janë një familje e madhe e viruseve që janë të zakonshëm tek njerëzit dhe në shumë lloje të ndryshme të kafshëve, duke përfshirë këtu devetë, bagëtitë, macet dhe lakuriqët e natës. Rrallëherë, koronaviruset e kafshëve mund të infektojnë njerëzit dhe pastaj të përhapen tek ta siç ka ndodhur me SARS-CoV, MERS-CoV dhe tani me SARS-CoV-2 apo COVID-19.

Koronavirusi i ri COVID- 19. Në 31 dhjetor 2019, pati disa raste me pneumoni në Wuhan, provinca Hubei, Kinë ku shumica e tyre raportonin ekspozim në një treg të madh të produkteve të detit ku shiteshin shumë lloje të kafshëve të gjalla. Të dhënat paraprake tregojnë se 2019 – CoV ka homologji për disa

⁹ Bazuar në nenin 1, “Objekti”, të ligjit Nr.10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

¹⁰ Për më shumë informacion referohu tek aneksi 1 i këtij protokoll

amino acide me SARS – CoV dhe mund të përdorë si receptor ACE2. Që prej 11 shkurt 2020 sëmundja e shkaktuar nga ky virus u quajt COVID-19 (CO- lidhet me Koronavirus; VI- lidhet me virusin; D-lidhet me sëmundjen (Disease) dhe '19 lidhet me vitin) ndërsa virusi u emërtua SARS-CoV-2. **Simptomat** varen nga virusi, por shenjat e zakonshme përfshijnë simptomat e aparatit të frymëmarrjes: ethe, kollë, marje fryme dhe vështirësi në frymëmarrje. Në raste më të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, sindromë të rëndë respiratore akute, insuficiencë të veshkave, madje edhe vdekje. Njerëzit më të ndjeshëm ndaj formave të rënda janë të moshuarit dhe ata me sëmundje ekzistuese, të tilla si diabeti dhe sëmundjet e zemrës. **Periudha e inkubacionit** paraqet periudhën e kohës midis infeksionit dhe zhvillimit të simptomave klinike. Aktualisht vlerësohet se ndryshon midis 2 dhe 11 ditëve, deri në maksimumi 14 ditë. Koronavirus i ri është një virus i rrugëve të frymëmarrjes që përhapet kryesisht përmes kontaktit të ngushtë me një person të sëmurë. **Mënyrat kryesore të përhapjes** nga personi i infektuar janë nëpërmjet: pështymës, kollitjes dhe teshtitjes; kontakteve personale të drejtpërdrejta si duarve, për shembull duke prekur me duart e ndotura (ende jo të lara) gojën, hundën apo sytë; në raste të rralla, infeksioni mund të ndodhë përmes kontaminimit fekal. Zakonisht sëmundjet e frymëmarrjes nuk transmetohen me ushqim, i cili në çdo rast duhet të trajtohet duke respektuar praktikën e mira të higjienës dhe duke shmangur kontaktin midis ushqimit të papërpunuar dhe atij të gatuar. Aktualisht nuk është e mundur të parashikohet se sa do të zgjasë shpërthimi epidemik nga Koronavirusi i ri dhe si do të zhvillohet. Kemi të bëjmë me një virus të ri dhe prandaj mbeten shumë paqartësi. Për shembull, nuk dihet nëse transmetimi do të ulet gjatë verës, siç vërehet për gripin sezonal¹¹.

3. SI DUHET TË VEPROHET PËR PËRBALLIMIN E NJË PANDEMIE

3.1. RREGULLAT E PËRGJITHSHME

Siç theksohet në këshillat dhe informacionin e vazhdueshëm që jep në mënyrë të përditësuar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo Instituti i Shëndetit Publik, por edhe në praktikën më të mira ndërkombëtare të përballimit të pandemisë COVID-19, është e rëndësishme që edhe në qendrat rezidenciale të ofrimit të shërbimit të strehimit, **të respektohet detyrimisht një minimum rregullash ku të parashikohet zbatimi i masave mbrojtëse për të shmangur rrezikun e infektimit apo të shpërndajës së virusit të COVID-19.**

Në përputhje me sa më sipër rregullat për vazhdimin e funksionimit të strehëzave përshkruhen në vijim:

- Gjatë periudhës së izolimit për shkak të emergjencës¹², punonjëset e strehëzave të cilat përbëjnë stafin bërthamë të ofrimit të shërbimeve, duhet të qëndrojnë dhe jetojnë në stehëz. Pjesa tjetër mund të shkojë në shtëpi dhe të ofrojë shërbimet që janë të rëndësishme, përmes telefonit.
- Punonjëset me kohë të pjesshme dhe vullnetaret e strehëzave gjithashtu mund të mos paraqiten në stehëz dhe të ofrojnë shërbime në distancë (me telefon, whatsapp, etj)

¹¹ Për më shumë detaje mbi COVID-19, lutemi referohuni te: <http://www.ishp.gov.al/pyetje-dhe-pergigje-te-shpeshta-virusi-dhe-semundja-nga-covid-19/>

¹² Nënkupto periudhës së ndalimit/kufizimit të lëvizjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, Urdhër i ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 132, datë 08.03.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo-publike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, Urdhër i ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 193, datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, etj. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/masat-e-reja-per-te-parandaluar-perhapjen-e-covid-19/>

- Zgjateni qëndrimin për të gjitha përfitueset që ishin / janë aktualisht në strehëz, të paktën derisa të hiqet izolimit për shkak të emergjencës.
- Mos lejoni asnjë visitor/e në strehëz deri në përfundimin e situatës së izolimit për shkak të emergjencës
- Mos lejoni hyrje/dalje në strehëz, me përjashtim të punonjëseve përgjegjëse për blerjen e ushqimit dhe produkteve të tjera thelbësore. Në këtë rast:
 - o Merrni masa që punonjësja që del për blerje të jetë e pajisur me të gjitha mjetet mbrojtëse (maskë, dorashka) dhe sigurohuni që ajo i njeh mirë të gjitha rregullat për të ruajtur distancën fizike 1.5-2 metër nga të tjerët, për të mos prekur me duar fytyrën, gojën, sytë, hundën, si dhe rregullat e tjera të reagimit në rast teshtitjeje, kollitjeje, etj (për më shumë detaje shihni shpjegimin në seksionin 3.2, pika 2/a)
 - o Kur punonjësja kthehet në strehëz së bashku me blerjet, duhet të lerë jashtë këpucët, të bëjë menjëherë ç'paketimin (heqjen e produkteve nga qeset me kujdes dhe hedhjen e qeseve në kosh, së bashku me dorezat dhe maskën e përdorur), të lajë menjëherë duart me sapun e ujë të rrjedhshëm për 20 sekonda, të vendosë në vendin e tyre produktet e blera dhe më pas të lajë sërish duart me sapun e ujë të rrjedhshëm për 20 sekonda, përpara sesa të prekë ndonjë gjë tjetër.
- Përgatituni për një periudhë izolimi për shkak të emergjencës, që nuk dihet sa zgjat, duke bërë rezervimin e ushqimit dhe furnizimet thelbësore, si kitet e dinjitetit, sapun, desinfektues duarsh, maska për fytyrën (leckë mjekësore dhe e thjeshtë, ndërsa maskë mjekësore vetëm për personat me simptoma të infektimit nga COVID-19), dorashka, mjete pastruese dhe desinfektuese të ambjentit, peshqirë letre (ose letra guzhine), shami letre, qese për grumbullimin e mbeturinave, produkte të higjienës vetjake, etj. Gjithashtu është e rëndësishme të keni gjendje një numër të mjaftueshëm termometrash (p.sh nga një për dhomë, por jo termometra që masin temperaturën nga goja) si dhe një sasi të mjaftueshme të ilaceve për trajtimin e sëmundjeve të caktuara dhe shqetësimeve të caktuara të stinës (apo me të cilat mund të jeni ndeshur më herët gjatë trajtimit të rasteve në strehëz (siç ju këshillon mjeku i strehëzës).
- Informoni të gjitha përfitueset aktuale në strehëz për çdo vendim që merret nga qeveria për zgjatjen e periudhës së izolimit oër shkak të emergjencës dhe sigurojini ato që i keni marrë masat e duhura për të mos cënuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve.
- Tregoni vëmendje maksimale dhe merrni të gjitha masat parandaluese paraprake, edhe nëse asnjë përfituese apo punonjëse e strehëzës nuk shfaq shenja të një infektimi të mundshëm me COVID-19. Kjo pasi, mund të ndodhë që të ketë persona mbartës të virusit të cilët nuk shfaqin simptoma. Me fjalë të tjera, konsideroni të gjithë personat si të prekur me COVID-19, për të respektuar rigorozisht masat e distancimit social, rregullat e higjienës, masat parandaluese, etj., por KUJDES, të mos krijoni mundësi për diskriminim apo keqtrajtim të përfitueseve dhe punonjëseve (shmangni bullizmin nga etiketimet e panevojshme “viktimë e COVID”, “burim infeksioni”, etj)

- Shpjegojuni me kujdes dhe imtësi përfitueseve:
 - çfarë është COVID-19,
 - cilat janë masat paraprake parandaluese,
 - përse nevojitet kufizimi, si do të ndikojë kjo në mënyrën e të jetuarit në strehëz,
 - përse ka rëndësi respektimi me rigorozitet i të gjithë rregullave të reja të vendosura,
 - përse ka ndryshime në rregullore (duke saktësuar edhe se cilat janë ato),
 - si duhet të sillen dhe reagojnë në situata të caktuara, etj.

- Kur është e mundur shoqëroni të gjitha shpjegimet e mësipërme edhe me postera ilustrues të afishuara në ambientet e strehëzës, postera të larjes dhe desinfektimit të duarve në tualete dhe në ambientin e ngrënies, rregullat e ndryshuara të printuara dhe afishuara, etj.

- Printojeni dhe afishojeni në vende të dukshme çdo ndryshim në rregullore, që lidhet me funksionimin e strehëzës për periudhën e emergjencës së pandemisë COVID-19, Njëkohësisht sqaroni të gjitha punonjëset dhe banoret për këto ndryshime dhe kohëzgjatjen e tyre. Sigurohuni që sqarimet të jenë me gjuhë të përshtatshme dhe të kuptueshme nga/për të gjitha grupet e përfitueseve dhe po kështu edhe materialet e afishuara

- Aplikoni sa më shumë të jetë e mundur masa të distancimit social, pra përfitueset në qendër të mbahen sa më larg njëra tjetrës, si dhe të qëndrojnë mundësisht në dhoma të veçanta (nëse hapësira dhe numri i përfitueseve e lejojnë këtë gjë). Po kështu, qëndrimi në tavolinë për konsumimin e vakteve (nëse e lejon hapësira) të bëhet duke ruajtur distancën të paktën 1 metër larg njëra tjetrës, ose të organizohet konsumimi i vakteve me disa frekuenca orare. Distancimi social është mirë të ruhet edhe ndërmjet punonjëseve, si edhe ndërmjet punonjëseve dhe përfitueseve.

- Zbatoni një rutinë ditore në mënyrë strikte dhe të rregullt ku të përfshihen:
 - Pastrimi dhe sterilizimi i rregullt i të gjitha ambjenteve të strehëzës dy herë në ditë
 - Pastrimi dhe sterilizimi i sipërfaqeve apo mjeteve me të cilat ka kontakt më të shpeshtë (tavolina, dorezat e dyerve, doreza e frigoriferëve, mjetet personale si celularë, etj.) çdo dy orë
 - Matja e temperaturës (së punonjëseve dhe banoreve) dhe mbajtja shënimi e saj dy herë në ditë (jo me termometër që mat temperaturën nëpërmjet gojës). Sterilizoni termometrën pas matjes.
 - Nëse ambientet e higjenes vetjake (dush) dhe të lavanderisë nuk janë të ndara, të përgatitet një orar i shfrytëzimit të tyre nga secila përfituese dhe punonjëse
 - Mbajtja e higjenes vetjake përmes të bërit dush të paktën një herë në ditë (për të gjitha përfitueset dhe punonjëset të cilat qëndrojnë në qendër)
 - Zbatimi i rregullt të larjes së shpeshtë të duarve me ujë të rrjedhshëm e sapun për jo më pak se 20 sekonda (minimalisht sa herë që shkohet në tualet, përpara dhe pas ngrënies, përpara gjumit, sa bëhet zgjimi, sa herë teshtitet apo kollitet, etj). Përdorimi i desinfektuesit të duarve sa herë të jetë e mundur dhe detyrimisht në pamundësi të larjes së duarve

- Shmangni kontaktet me prekje dhe dhënien e duarve ndërmjet përfitueseve, punonjëseve, përfitueseve dhe punonjëseve
 - Shmangni prekjen e fytyrës, gojës, hundës dhe syve me duar të papastru apo të padesinfektuara
 - Shmangni përdorimin e përbashkët apo shkëmbimin mes njëra tjetrës së sendeve personale. Përdorni peshqirë personale si për duart edhe për fytyrën apo për dushin. Shmangni përdorimin e të njëjtëve peshqirë edhe ndërmjet nënës dhe fëmijës përfitues të shërbimit të strehimit. Kur është e mundur zëvendësoni peshqirët e copës për duart dhe fytyrën me ato të letrës dhe pas përdorimit hidhini menjëherë në koshin e mbeturinave.
 - Mbani rregullisht higjienën në tualetet (si ato të dhomave dhe ato të përbashkëta). Kujdesuni që në tualete të mos mungojnë sapuni dhe mjetet e tjera desinfektuese, si dhe ato për pastrimin dhe higjienizimin e tualetit. Në mënyrë të veçantë tualetet e përbashkëta duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit nga secili person që i përdor
 - Ajroseni strehëzën duke hapur dritaret gjatë ditës dhe mbyllini në darkë.
 - Shmangni sa më shumë qëndrimin në një ambjent të përbashkët dhe takimet e përbashkëta. Për takime apo diskutime që duhet të zhvillohen domosdoshmërisht, kur e lejon infrastruktura e godinës së strehëzës, shfrytëzoni ambiente të hapura si terraca apo oborre, ose dhoma të mëdha ku mund të respektohet distanca nga njëra tjetra. Në pamundësi, kërkojuni të gjitha pjesëmarrëseve në takim të mbajnë maska dhe doreza, të mos prekin, japin dorën apo përqafojnë njëra-tjetrën, të mos prekin fytyrën me duar gjatë takimit, të lajnë menjëherë duart në përfundim të tij, etj.
- Përgatisni të paktën një dhomë izolimi, mundësisht me tualet brenda ose me tualetin ngjitur. Dhoma duhet të ketë edhe dritare për ajrosje dhe duhet të jetë e gatshme për përdorim si në rast se dikush nga përfitueset aktuale në strehëz shfaq shenja të një infektimi të mundshëm, ashtu edhe nëse në strehëz do të paraqitet një përfituese e re për t'u përfshirë në shërbim. Pajiseni atë me të gjitha mjetet dhe produktet që ju siguron zakonisht për të gjitha përfitueset dhe siguron edhe materiale shtesë për argëtimin e tyre dhe për t'i mbajtur ato (dhe fëmijët shoqëruar) të zënë (libra, lojëra, materiale artizanale, ngjyra, letra).
 - Këshillojini punonjëset të informohen sa më shumë rreth ndikimit të COVID-19 tek situata e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (shiko aneksin 2 të këtij protokoll)

3.2. HAPAT QË DO TË NDIQEN NËSE NJË PËRFITUESE SHFAQ SIMPTOMA TË INFEKTIMIT TË MUNDSHËM ME COVID-19

Nëse një përfituese shfaq simptoma të infektimit të mundshëm me COVID-19, si kollë e thatë, temperaturë e lartë, vështirësi në frymëmarrje, dhimbje muskujsh dhe dobësi, veproni menjëherë si në vijim:

- Shpjegojini përfitueses se simptomat që po shfaq paralajmërojnë se mund të ketë COVID-19 dhe bazuar në udhëzimet të Komitetit Teknik të Përkohshëm të ngritur për përbalimin e

emergjencës së pandemisë COVID-19, duhet të trajtohet si rast i dyshuar ose person nën hetim. Për këtë qëllim përfituesja duhet të mbahet në dhomën e izolimit dhe nën kontroll.

- Zhvendoseni atë në dhomën e veçantë për izolim dhe jepini një maskë për fytyrën
- Shpjegojani se COVID-19 është shumë infektiv por shumica e personave të infektuar shërohen pa ndërhyrje mjekësore. Por është e rëndësishme që të zbatohen me rigorozitet të gjitha rregullat dhe këshillat për këtë situatë.
- Shpjegojani edhe një herë të gjitha rregullat e kujdesit personal dhe të higjienës
- Sqarojani se do të duhet të qëndrojë në një dhomë të veçantë për 14 ditë.
- Shpjegojani se përfituesja do t'i marrë të gjitha shërbimet e akomodimit, ushqimit, setit të dinjitetit (dhe çdo send tjetër që zakonisht u siguron të gjitha përfitueseve)
- Informojeni për masat e veçanta të marra për t'i krijuar mundësinë të angazhohet me diçka dhe të kalojë kohën sa më qetë/këndshëm gjatë periudhës së izolimit
- Shpjegojini përfitueses se do t'i lejohet përdorimi i një telefoni celular por duke i theksuar rregullat për sigurinë për përdorim të telefonit celular. Vëreni në dijeni që psikologjia e qendrës do ta kontaktojë në celular dhe ndihmojeni të ruajë në celular numrin e saj.
- Përgatisni një plan për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe për rutinën ditore të përfitueses. Nëse ajo ka nevojë për mbështetje psiko-sociale mundësojani kryesisht përmes telefonit. Sugjerohet që këshilluesja të mbajë komunikim me telefon të paktën dy herë në ditë me të.
- Të gjitha ushqimet duhet t'i serviren përfitueses në derën e dhomës së saj. Vendosjani ushqimin tek dera dhe njoftojeni që ta marrë, ndërkohë që ju largoheni dhe ruani distancën. Pasi mbaron së ngrëni, përfituesja duhet të pastrojë enët me pastrues (i cili duhet të jetë i vendosur në dhomën e saj) dhe t'i lerë ato tek dera. Punonjësja e strehëzës, duhet t'i marrë (patjetër me dorashka) dhe t'i dezinfektojë dhe lajë (siç u përshkrua më sipër tek 3.3). Pasi t'i verë në vend duhet të lajë dhe dezinfektojë sërish duart.
- Në varësi të simptomave që shfaq përfituesja e izoluar, konsultohuni me mjekët në numrin 127 ose në linjën jeshile 08004040.
- Shpjegojani përfitueses që për sa kohë nuk shfaq shenja klinike nuk mund t'ë bëjë testin molekular (tamponin)
- Fëmijët e përfitueses (nëse ka) gjithashtu duhet të kalojnë në izolim dhe duhet të konsiderohen si mbartës potencialë. Nuk këshillohet qëndrimi i fëmijëve me nënën në dhomën karantinë, por kjo varet shumë nga mosha e fëmijës dhe nga kapacitetet njerëzore e infrastrukture që ka strehëza për të bërë izolimin e fëmijës në një dhomë tjetër. Vendimi për izolimin e fëmijës së bashku me nënën (apo më vehte nëse ekzistojnë kushtet dhe nëse fëmija është mbi 14 vjeç)

duhet të merret në konsultim edhe me Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

- Nëse simptomat klinike shtohen gjatë periudhës së izolimit njoftoni në numrin 127. KUJDES: duhet të merren masa që të mos bëhet publike vendndodhja e strehëzës (pra gjatë njoftimit në numrin 127 për dyshimin për personin e infektuar, të bëhet edhe paralajmërimi që adresa e Strehëzës duhet të mbetet konfidenciale). Bërja publike e vendndodhjes së strehëzës vë në rrezik jetët e banoreve dhe punonjëseve të tjera jo vetëm për situatën e emergjencës, por edhe në terma afatgjatë
- Nëse nga kryerja e testit molekular (tamponit) përfituesja rezulton pozitive me COVID-19 përfituesja kalon për ndjekje të mëtejshme në një nga spitalet COVID.
- Testi molekular i bëhet detyrimisht edhe fëmijës shoqëruar (nëse ka dhe ka qëndruar me nënën në izolim për një periudhë 5 ditore), edhe pse mund të mos ketë shenja klinike. Nëse nga testi fëmija del negativ për COVID-19, në varësi të moshës së tij merret vendimi për mënyrën se si do të procedohet për vetë-izolimin e tij edhe për të paktën 14 ditë të tjera. Për këtë duhet njoftuar edhe Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

3.3. HAPAT SPECIFIKË TË MENAXHIMIT TË SITUATËS

Shembuj të praktikave të mira të krijuara si rezultat i përballjes me epidemi të ngjashme¹³ dhe njëkohësisht edhe me vetë pandeminë e COVID-19¹⁴, sugjerojnë se plani i përballimit të kësaj pandemie nga institucionet rezidenciale të ofrimit të shërbimeve të specializuara të strehimit, mund të përmbajë të paktën pesë hapat në vijim, zbatimimi i të cilave ndërthuret dhe plotëson zbatimin e "Rregullave të përgjithshme" të sipërcituara (seksioni 3.1) :

1. Monitorimi i rrezikut aktual të pandemisë.

- a. Ndiqni rregullisht njoftimet që jepen nga Instituti i Shëndetit Publik mbi përhapjen e pandemisë në nivel kombëtar, rajonal e botëror
- b. Blini maska, furnizime shtesë me higjienizues, pastrues duarsh dhe desinfektuesit e nevojshëm për higjienën personale dhe të godinës
- c. Informoni dhe trajtoni vazhdimisht punonjëset dhe përfitueset mbi masat parandaluese të COVID-19 dhe mënyrën e zbatimit të tyre në praktikë, duke u bazuar gjithmonë në informacion të përditësuar
- d. Monitoroni dhe përmirësoni në mënyrë të vazhdueshme mbajtjen e higjienës së përditshme të godinës dhe të gjitha ambjenteve të saj, për të shmangur rrezikun e përhapjes së mundshme të COVID-19
- e. Monitoroni vazhdimisht situatën e punonjësve të strehëzës:
 - o Ndani rregullisht informacion të përditësuar mbi masat parandaluese

¹³ Përshtatur nga materiali publikuar në mars 2020 në: <https://endvaw.ca/wp-content/uploads/2020/03/PANDEMIC-PREPAREDNESS--YWCA-NWT.pdf>

¹⁴ Protokoli për funksionimin e strehëzave në periudhën e emergjencës së COVID-19" i rekomanduar nga Komisioni Kombëtar i Grave, Nepal, përgatitur me mbështetjen e Bankës Botërore, version i datës 7 prill 2020

- Kërkoni të qëndrojnë në shtëpi ato punonjëse që mund të jenë të sëmura (edhe nëse nuk kanë shenja të COVID-19)
 - Mbani parasysh se cilat nga punonjëset mund të jenë më në rrezik nëse ekspozohen ndaj COVID-19, apo cilat kanë përgjegjësi të shtuara (p.sh. janë nëna të vetme, kanë fëmijë të vegjël, kanë të moshuar në shtëpi, etj.
 - Diskutoni me to planin e përballimit të pandemisë dhe në mënyrë të veçantë këtë protokoll.
- f. Raportoni menjëherë çdo dyshim për rast të infektuar me COVID-19, qoftë kjo përfituese e shërbimit apo punonjëse e strehëzës.
- g. Përmirësoni vazhdimisht planin e emergjencës të përgatitur nëse do ndesheni me një rast të një personi të infektuar me COVID-19, duke u bazuar edhe në informacionin e përditësuar mbi pandeminë dhe masat e rekomanduara. Kujtoni që nëse i konsideroni të gjithë si të prekur nga COVID-19 ndërgjegjësoheni më shumë për të ruajtur distancimin social dhe për të respektuar masat parandaluese, POR shmangni rrezikun e kthimit të këtij mendimi në një mjet diskriminimi apo bullizmi.
- h. Përshkruani qartë se çfarë veprimesh po ndërmerr strehëza për të mbrojtur përfitueset, duke u shpjeguar se çfarë edhe përfitueseve se mund të bëjnë për të mbrojtur veten dhe personat e tjerë

2. Rishikoni dhe përmirësoni protokollet e mbrojtjes personale dhe të godinës së strehëzës.

- a. **Protokolli i mbrojtjes personale** kërkon zbatimin në mënyrë rigoroze të këtyre këshillave:
- Mbuloni gojën dhe hundën nëse teshtini apo kolliteni;
 - Lani duart sa më shpesh të jetë e mundur me ujë të rrjedhshëm dhe sapun dhe disinfektojini ato me alkool
 - Pastroni dhe higjenizoni vazhdimisht sende të përdorimit personal si telefon, kompjuter, dyer, tavolina, frigoriferë, etj
 - Nëse një punonjëse ka ethe, duhet të qëndrojë në shtëpi të paktën edhe 24 orë pas kalimit të kësaj situate shëndetësore.
 - Nëse një përfituese (ose fëmija shoqëruar i saj) ka ethe ose simptoma të ngjashme me shenjat parajamëruese të infektimit nga COVID-19, duhet të njoftojë menjëherë punonjësen e strehëzës.
 - Shpjegojni përfitueseve procedurën që do të ndiqet nëse konstatohen shenja parajamëruese të infektimit të mundshëm me COVID-19 (sç përshkruhen në pikën 3.2 më sipër).
 - Përfitueset mund të kenë ankth dhe pyetje në lidhje me COVID-19 dhe izolimin për shkak të emergjencës. Siguroni informacion të saktë dhe të verifikuar nga burime zyrtare rreth situatës në lidhje me masat parandaluese, si dhe planifikoni këshillime të rregullta për to.
 - Si punonjëse në strehëzën për viktimat e dhunës në familje apo trafikimit, mos harroni se është e natyrshme të përjetoni një stres të shtuar, në këtë situatë, pasi ju merrni pjesë në nevojat e përfitueseve gjatë shpërthimit të COVID-19. Prandaj mund të adoptoni disa teknika të thjeshta për të menaxhuar nivelin e

stresit tuaj duke zhvilluar një rutinë të përditshme dhe duke u përqëndruar në nevojat bazë: pushoni mjaftueshëm, ushqehuni në orare të rregullta, praktikoni frymëmarrje të thellë dhe qëndroni të lidhur (qoftë dhe virtualisht) me familjen dhe të afërmit e miqtë. Nëse ndonjë prej anëtarëve të familjes tuaj nga testi molekular (tampon) rezulton pozitiv për COVID-19, praktikoni të gjitha masat e përshkruara më sipër. Nëse ju duhet të merrni leje për t'u kujdesur për anëtarët e familjes tuaj, flisni me drejtuesen dhe planifikoni një zëvendësim. Nëse ju (ose ndonjë nga anëtarët e familjes tuaj) duhet të flisni me një psikolog/e, kontaktoni me psikologët e strehëzës ose të organizatave partnere me të cilat ju bashkëpunoni.

b. **Protokolli i mbrojtjes së banoreve (punonjëse e përfitese) të strehëzës** kërkon zbatimin në mënyrë rigoroze të këtyre rregullave:

- Fëmijët nuk mund të mbahen nën kujdesin e / apo të kujdesen për përfitueset e sëmura dhe të dyshuara si të infektuara me COVID-19
- Përfituesja e sëmurë por pa shenja që do ta klasifikonin si rast të dyshuar¹⁵, të mbahet sa më larg të jetë e mundur nga personat e tjerë dhe dera e dhomës ku qëndron të mbahet e mbyllur;
- Caktoni punonjëset që mund të ofrojnë kujdes për përfitueset e sëmura po jo rast i dyshuar, duke pasur parasysh që këtë detyrë ta mbajnë ato më pak në risk në rast infektimi;
- Kërkojuni përfitueseve të sëmura por jo rast i dyshuar të lajnë vazhdimisht duart dhe të mbulojnë hundën dhe gojën nëse teshtijnë apo kolliten;
- Kur kujdeseni për një foshnjë, mbajeni kokën e saj mbi supin tuaj, me qëllim që të shmangni teshtitjen dhe kollitjen përpara fytyrës;
- Kërkojuni të gjitha banoreve në strehëz (përfituese apo punonjëse) të lajnë vazhdimisht duart dhe të përdorin letër guzhine apo peshqirë personale për tharjen e tyre, me qëllim shmangien e përhapjes së virusit;
- Krijoni kushte të distancimit social, duke anuluar aktivitetet në ambjentet e përbashkëta si dhe duke larguar krevatët në dhomat e gjumit (aq sa e lejon hapësira dhe infrastruktura e godinës, duke konsideruar dhe parashikimet e dhëna në seksionin 3.1 më sipër) dhe nëse duhet të organizoni patjetër një aktivitet në një ambjent të përbashkët, kërkojuni të gjithë pjesëmarrësve të mbajnë maska dhe dorashka
- Maskat dhe shamitë e letrës duhet të hidhen menjëherë në kosh të mbyllur pas përdorimit dhe duhet të lahen menjëherë duart;

¹⁵ Sipas "përkufizimit të rastit" miratuar nga Komiteti Teknik i Përkohshëm, për situatën e pandemisë së COVID-19: që "Rasti i dyshuar ose personi nën hetim" klasifikohet sipas kritereve klinike dhe epidemiologjike dhe konsiderohet cilido person me: (a) Infeksion akut të traktit respirator (fillim i menjëhershëm i temperaturës dhe të paktën një prej shenjave të mëposhtme të sëmundjes respiratore si p.sh. kollë, vështirësi në frymëmarrje) DHE pa etiologji tjetër që të shpjegojë plotësisht paraqitjen klinike DHE me një histori udhëtimi ose qëndrimi në një vend apo zonë që ka raportuar transmetim lokal ose komunitar, gjatë 14 ditëve përpara fillimit të shenjave klinike; (b) Sëmundje akute respiratore DHE që ka qenë në kontakt të ngushtë me një rast COVID -19 të konfirmuar gjatë 14 ditëve të fundit, përpara fillimit të shenjave klinike; (c) Sëmundje respiratore e rëndë akute (temperaturë dhe të paktën një shenjë të sëmundjes respiratore p.sh. kollë, vështirësi në frymëmarrje) DHE që kërkon hospitalizim (SRRRA ose STRA*) DHE pa etiologji tjetër që të shpjegojë plotësisht paraqitjen klinike.

- Ambjentet e strehëzës duhet të mbahen sa më të hapura dhe të ajrosura.
- c. **Protokolli i pastrimit të godinës** kërkon zbatimin në mënyrë rigoroze të këtyre këshillave:
 - Lajini rrobat në ujë të nxehtë dhe shmangni mbajtjen e tyre afër vetes kur janë të palara
 - Pastroni lodrat dhe të gjitha sipërfaqet e ambienteve të strehëzës me sterilizues
 - Paketojini mirë dhe hiqini sa më shpesh mbeturinat sidomos kur në to ka edhe maska të përdorura apo shami letre
 - Lajini enët mundësisht me proces të plotë në lavastovilje - në mungesë të lavastoviljes, sigurohuni t'i fusni në një enë me dezinfektues përpara sesa t'i lani me ujë të ngrohtë e sapun dhe kur t'i thani, peshqirin që përdorët për tharje futeni menjëherë në lavatriçe
 - Lëndët dezinfektuese për ambientet, mjetet, lodrat, sipërfaqet, etj., të jenë me përmbajtje të lartë klori dhe alkoli 90% apo 100%, si dhe dezinfektantët me sferë veprimi edhe në viruse
 - Zëvendësoni peshqirët e copës me letra guzhine.

3. Reduktoni propabilitetin e përhapjes dhe ndikimin e pandemisë

- a. Përgatitni dhe mbështesni punonjëset përmes:
 - Përgatitjes së planit të përballimit të situatës sidomos në pikun e saj, duke parashikuar edhe situata kur një pjesë e stafit do të duhet të qëndrojnë mbyllur në strehëz me përfitueset (kur këtë gjë e lejon hapësira dhe infrastruktura)
 - Trajtoni vazhdimisht punonjëset mbi strategjitë e mbrojtjes dhe respektimin e protokollit të emergjencës – të mos paraqiten në asnjë mënyrë në punë nëse kanë shenja të sëmundjes, apo edhe të një gripi të thjeshtë!!
 - Identifikoni mënyra të krijimit të distancimit social, duke zëvendësuar takimet ballë për ballë me ato on-line, edhe kur terapistja apo këshilluesja janë të pranishme në strehëz
 - Krijoni një sistem mbështetës me vullnetarë të trajnuar nga ju më parë për të ofruar shërbime në strehëz (qoftw edhe on-line) në rast nevojë;
 - Krijoni një sistem mbështetës për trajtimin e fëmijëve të sëmurë, apo edhe për punonjëset nëna kryefamiljare.
- b. Siguroni materialet mbështetëse të domosdoshme:
 - Bëni një inventar të detajuar të godinës dhe ambienteve të saj për të përlogaritur burimet në dispozicion dhe ato që mund t'ju nevojiten në rast të funksionimit me kapacitet të plotë (pra mjete burime, furnizime për person)
 - Sigurohuni të keni rezerva të mjaftueshme për 6-8 javë gjatë pikut të pandemisë, në lidhje me produktet ushqimore, të pastrimit dhe higjienizimit, mjekime në varësi të formave të ndryshme të sëmundjeve me të cilat jeni ndeshur më parë, termometra për të rritur dhe fëmijë, etj.
 - Kontrolloni dhe mbushni vazhdimisht kutitë me sapun dhe dezinfektantë, peshqirët e letrës, maskat dhe dorashkat për secilin individ në strehëz, etj.

4. Vazhdojeni veprimtarinë edhe gjatë periudhës së pikut të pandemisë, por me staf të reduktuar:

- a. Theksoni respektimin e protokollit dhe masave parandaluese të detyrueshme
- b. Kufizoni lëvizjet e punonjëseve dhe të përfitueseve, si dhe mos lejoni në asnjë mënyrë vizitorë
- c. Nëse evidentohet se një punonjëse ka pasur kontakt me persona të infektuar nga COVID-19, ajo duhet detyrimisht të shkojë në shtëpi dhe të vetë-izolohet për të paktën 14 ditë.
- d. Ndërsa nëse evidentohet se një përfituese ka pasur kontakt me persona të infektuar nga COVID-19 duhet të izolohet në dhomën e përgatitur në strehëz për këtë qëllim. Në rast nevoje, përfitueset me të njëjtat simptoma mund të futen në të njëjtën dhomë izolimi, por duke ruajtur distancën nga njëra tjetra. Nëse simptomat klinike shtohen gjatë periudhës së izolimit dhe nga kryerja e testit molekular (tamponit) përfituesja rezulton pozitive me COVID-19 duhet të lidhemi nëpërmjet 127 me spitalet COVID, për të bërë transportimin e saj për ndjekje të mëtejshme.
- e. Në pamundësi për ta izoluar përfituesen (për mungesë hapësire/infrastrukture, apo për shkak se strehëza i ka të gjitha vendet e zëna, etj), duhet të komunikohet menjëherë me Koordinatorin Vendore kundër Dhunës në Familje në Bashki, me Shërbimin Social Shtetëror dhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjetur një alternativë qëndrimi në vetë-izolim në një godinë tjetër (të përcaktuar nga shteti për karantinimin) duke mos e privuar përfituesen nga shërbimet mbështetëse të speciaizuara të cilat do të ofrohen duke ruajtur rregullat e distancimit apo të këshillimit me telefon, etj (shiko rregullat e shpjeguara në seksionet më sipër në këtë protokoll).
- f. Mbani rregullin e funksionimit të strehëzës dhe të ndërrimit të turneve elektronikisht, duke shmangur mbipopullimin në strehëz
- g. Ndërkohë që gatimi do vijojë të jetë i përbashkët për të gjitha banoret, shmangni vetëshërbimin dhe caktoni një punonjëse e cila, duke respektuar masat paraprake, të bëjë shpërndarjen e ushqimit në pjata dhe sete individuale. Krijoni kushte të respektimit të distancimit social gjatë procesit të ngrënies
- h. Kufizoni sa më shumë ambientet e përbashkëta dhe për fëmijët krijoni kushte që të qëndrojnë në dhomat e tyre (sigurojuni lodra dhe mjete didaktike)

5. Vlerësoni situatën dhe vijoni me masa të tjera përgatitore edhe pas përfundimit të situatës së emergjencës

- a. Bëni një vlerësim të ndikimit që pati periudha e emergjencës së pandemisë COVID-19 në shërbimin tuaj (mbi punonjëset, përfitueset, etj)
- b. Kthehuni gradualisht respektimit të standardeve të aplikueshme në situata jo të emergjencës nga pandemia
- c. Planifikoni planin e emergjencës në rast ri-përsëritjeje të rrezikut të pandemisë COVID-19, duke u bazuar edhe në mësimet e nxjerra nga përballimi i kësaj situatë.

3.4. HAPAT QË DUHET TË NDIQEN PËR PRANIMIN E NJË PERSONI TË RI NË STREHËZ

Cilado viktimë/e mbijetuar e dhunës në familje apo trafikimit ka të drejtën e saj për t'u trajtuar me shërbime mbështetëse të specializuara, edhe në situatën e emergjencës së COVID-19. Dyshimi mbi kushtet shëndetësore të saj nuk mund të kthehet në faktor diskriminues për mohimin e të drejtës për t'u trajtuar me shërbime mbështetëse të specializuara si dhe për t'u mbrojtur.

Për çdo rast të ri që paraqitet me nevojën për t'u strehuar në strehëz do të ndiqen në mënyrë të detyrueshme hapat në vijim:

- Përfituesja e shërbimit (dhe fëmija shoqëruar) duhet të mbahet në izolim në dhomën e veçantë që ju keni përgatitur për izolim (siç u përshkrua seksionet 3.1 dhe 3.2 më sipër). Asaj duhet t'i ofrohet shërbimi i domosdoshëm, duke ruajtur në mënyrë rigorozë distancën dhe përdorimin e mjeteve parandaluese (maskë, dorashka), edhe nëse nuk ka ndonjë simptomë të COVID-19.
- Përfitueses së re (dhe fëmijëve shoqëruar nëse ka) u bëhet e ditur që përpara mbërritjes në strehëz, se do t'u duhet të qëndrojnë 14 ditë të izoluar në dhomën e përcaktuar në strehëz për këtë qëllim. Me pranimin e këtij kushti, cilado/cilado që hyn në strehëz, duhet së pari të ketë matur temperaturën dhe përpara se të hyjë, të desinfektojë këpucët si dhe duart me desinfektues me alkool.
- Komunikoni me të dhe jepini të gjitha mesazhet e mirëseardhjes e orientimit siç bëni zakonisht kur pranohet në strehëz një rast i ri. Shpjegojani të porsaardhurës se është e mirëpritur në strehëz dhe se masat që po merren janë në kuadër të emergjencës për shkak të COVID-19.
- Shpjegojani se COVID-19 është shumë infektiv por shumica e personave të infektuar shërohen pa ndërhyrje mjekësore. Por është e rëndësishme që të zbatohen me rigorozitet të gjitha rregullat dhe këshillat për këtë situatë.
- Shpjegojani të gjitha rregullat e kujdesit personal dhe të higjienës (siç përshkruhen në seksionin 3.1 më sipër të këtij protokolli)
- Shpjegojani se përfituesja do t'i marrë të gjitha shërbimet e akomodimit, ushqimit, setit të dinjitetit (dhe çdo send tjetër që zakonisht u siguron të gjitha përfitueseve)
- Informojeni për masat e veçanta të marra për t'i krijuar mundësinë të angazhohet me diçka dhe të kalojë kohën sa më qetë/këndshëm gjatë periudhës së izolimit
- Shpjegojini përfitueses se do t'i lejohet përdorimi i një telefoni celular por duke i theksuar rregullat për sigurinë për përdorim të telefonit celular. Vëreni në dijeni që psikologjia e qendrës do ta kontaktojë në celular dhe ndihmojeni të ruajë në celular numrin e saj.
- Plotësoni formularin e pranimin dhe filloni me vlerësimin e nevojave të saj emergjente, duke i kujtuar punonjëses dhe përfitueses të zbatojnë rigorozisht masat parandaluese (distancën, maskën, dorashkat)

- Nëse gjatë periudhës së izolimit 14 ditore përfituesja shfaq simptomat e një infektimi të mundshëm, apo shenjat klinike të infektimit nga COVID-19, veproni siç u shpjegua me detaje në pjesët më sipër 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij protokollit
- Përgatitni një plan për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe për rutinën ditore të përfitueses së re (dhe fëmijës shoqërues të saj). Vijoni me menaxhimin e çështjes së saj, si zakonisht. Nëse ajo ka nevojë për këshillim ligjor apo mbështetje psiko-sociale mundësojani kryesisht përmes telefonit. Sugjerohet që këshilluesja të mbajë komunikim me telefon të paktën dy herë në ditë me të.
- Të gjitha ushqimet duhet t'i serviren përfitueses së re në derën e dhomës së saj. Vendosjani ushqimin tek dera dhe njoftojeni që ta marrë, ndërkohë që ju largoheni dhe ruani distancën. Pasi mbaron së ngrëni, përfituesja duhet të pastrojë enët me pastrues (i cili duhet të jetë i vendosur në dhomën e saj) dhe t'i lerë ato tek dera. Punonjësa e strehëzës, duket t'i marrë (patjetër me dorashka) dhe t'i desinfektojë dhe lajë (siç u përshkrua më sipër tek 3.3). Pasi t'i verë në vend duhet të lajë dhe desinfektojë sërish duart.
- Punonjëset e strehëzës dhe përfitueset e tjera duhet të komunikojnë me përfituesen e re dhe ta përfshijnë atë në biseda nëpërmjet derës së dhomës. Nëse përfituesja nuk ka ndonjë simptomë gjatë ditëve të qëndrimit në izolim, pas javës së parë, komunikimi me të mund të bëhet edhe me derën hapur duke ruajtur distancën. Gjeneroni mënyra krijuese për të mbajtur të angazhuar përfituesen e re, edhe pse në izolim.
- Pasi përfundon me sukses periudha 14 ditore e izolimit, prezantojeni përfituesen e re (dhe fëmijën shoqërues) me përfitueset e tjera dhe me ambientet e strehëzës, duke ruajtur distancën, duke mos lejuar takime me dhënie duarsh dhe duke shpjeguar rregullat e reja të vendosura në situatën e emergjencës (dhe duke zbatuar të gjitha masat e përshkruara në seksionet më sipër 3.1 dhe 3.3). Përpara se të bëni këtë prezantim, duhet të flisni me përfitueset e tjera dhe t'u shpjegoni që e ka kaluar me sukses periudhën 14 ditore të detyrueshme të vetë-izolimit dhe t'u kujtoni që të vijojnë me respektimi e rregullave të vendosura për shkak të situatës së pandemisë së COVID-19.

4. STANDARDET E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË STREHIMIT, NË KUSHTET E PANDEMISË SË COVID-19

Në Shqipëri, funksionimi i strehëzave bazohet në një tërësi standardesh kombëtare. Për strehëzat për viktimat e dhunës në familje, të planifikuara për ofrim shërbimi në terma afatgjatë, standardet janë të miratuara me VKM nr. 505 datë 13.07.2011 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike", si dhe Udhëzim Nr. 13, datë 17.12.2012 "Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike". Ndërsa për qendrat për viktimat e trafikimit, ekzistojnë standardet e miratuara me VKM nr. 195 datë 11.04.2007 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose

në rrezik trafikimi”. Po kështu, gjatë punës në strehëza mbahen në konsideratë edhe standardet minimale të udhëzuara sipas Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Gjithashtu ka standarde të miratuara edhe për funksionimin e strehëzave afatshkurtëra (të emergjencës) për viktimat e dhunës në familje¹⁶ dhe standarde për funksionimin e Qendrës së menaxhimit të krizës së dhunës seksuale “Lilium”¹⁷. Në kushtet e izolimit nga emergjenca e COVID-19, nisur nga natyra, kohëzgjatja dhe kufizimet infrastrukturore në këto qendra (hapësira të vogla, pamundësi për të caktuar një dhomë më vehte për izolim për qëndrimin 14-ditor siç e kërkon protokoli i trajtimit në rast të shfaqjes së simptomave, apo në rast të hyrjes së një përfitueseje të re në këtë shërbim), si dhe kufizimeve në burimet njerëzore, rekomadohet që vënia në funksionim e këtyre strehëzave afatshkurtëra, do të shqyrtohet sipas paraqitjes së nevojës, rast pas rasti, me një dakordësi të përbashkët me Bashkinë, ofruesin e shërbimit (për shërbim jo-publik), Shërbimin Social Shtetëror, si dhe Ministrinë e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale. Në rastin e qendrës “Lilium” për shkak të pozicionimit të saj në spital dhe rregullave të vendosura në kushtet e emergjencës COVID-19, shërbimi i specializuar për viktimat e dhunës seksuale, vetëm për periudhën e emergjencë, do të jepet përmes stafit me telefon. Nëse do ketë nevojë për ekzaminim dhe mbledhje provash, atëherë ekipi i specializuar për këtë qëllim do të shkojë të bëjë mbledhjen e provave në dhomën e izolimit të godinës ku do të merret vendimi për të strehuar viktimën (psh tek një strehëz afatgjatë, tek godinat e përcaktuara nga shteti për karantinim, etj). Edhe në këtë rast këtyre viktimave nuk do t’u mungojnë shërbimet mbështetëse që mund të jepen përmes telefonit, siç u shpjegua edhe në seksionet më sipërtë këtij protokoli.

Në tabelën në vijim paraqiten standardet e detyrueshme për t’u zbatuar nga strehëzat¹⁸ për viktimat e dhunës në familje që ofrojnë shërbime për një periudhë afatgjatë, si dhe ndryshimet që ato pësojnë në bazë të këtij protokoli për emergjencën COVID-19

STANDARDI EKZISTUES	NDRYSHIMI / PËRSHTATJA QË PËSON
<p>Standardi 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Shërbimet e ofruara nga ofruesi t’i plotësojnë nevojat individuale të përfituesit si viktimë e dhunës në familje.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve ofron një paketë të plotë dhe eficiente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në</p>	<p>- Tek “Shërbimet minimale të ofruara” ndryshon pika e fundit “Liri hyrje ditore” – e cila lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme, nëse përfituesja është e punësuar dhe aktiviteti i ndërmarrjes së saj nuk është ndaluar as në këtë situatë emergjence. Në këtë rast zbatohen në mënyrë rigoroze rregullat e parandalimit dhe mbrojtjes dhe lëvizja e përfitueses bëhet vetëm me mjetin e strehëzës.</p>

¹⁶ Udhëzim nr. 744 datë 15.11.2019 “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtëra) publike dhe jo-publike (strehëzat emergjente)”

¹⁷ Udhëzim nr. 816 datë 27.11.2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve për qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale”

¹⁸ Referohuni tek dokumenti i publikuar i standardeve në adresën:

<https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Botimi%20Standarted%202013.pdf>

<p>bashkëpunim me ofruesit parësor dhe alternativ të shërbimeve, për të mundësuar mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - “Shërbimet e tjera shtesë” në varësi të mundësisë jepen përmes teleworking, ose duke zbatuar rregullin e distancës sociale, duke kufizuar sa më shumë që të jetë e mundur kontaktet ballë për ballë. - “Shërbimi i specializuar për fëmijët” do të ofrohet me kohë të kufizuar, duke shmangur terapitë në grup - “Përfituesja merr pjesë në administrimin e programit” – ndryshon angazhimi i saj në gatimin e përbashkët, gatimi sugjerohet të bëhet nga një punonjëse në bashkëpunim me një nga përfitueset ekzistuese në qendër, të ciat duhet të respektojnë domosdoshmërisht rregullat e mbrojtjes dhe parandalimit. Sugjerohet sa më shumë ruajtja e distancës dhe mundësisht qëndrimi i përfitueseve në dhomat e tyre. - Shfuqizohet përkohësisht pika e lirisë së hyrje-daljeve të përfitueses sipas orarit të përcaktuar në kriteret e zbatimit të standardit.
<p>Standardi 2: Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesit për përfituesen</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Nevojat e përfitueseve të shërbimeve të jenë vlerësuar plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës dhe nevojave të tyre, në funksion të hartimit të planeve individuale të përkujdesit.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve të hartojë një plan përkujdesi individual, në bashkëpunim me secilën përfituese të shërbimeve. Në plan të përshkruhen qartë nevojat e vlerësuara të përfituesit dhe veprimet që nevojiten për t’i zgjidhur ose përmbushur këto nevoja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i këtij standardi mbetet i detyrueshëm, por me kushtin që gjatë komunikimit, të ruhet distanca, si dhe të vihen maskat dhe dorashkat si nga punonjësja/punonjëset ashtu edhe nga përfituesja e re e sapo futur në strehëz, e cila qëndron në dhomë më vehte për 14 ditë. <p>Plani i kujdesit afatgjatë mund të përfundojë pas periudhës së izolimit 14 ditor.</p>
<p>Standardi 3: Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitueseve</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përfitueset e shërbimeve t’i gëzojnë të gjitha të drejtat sipas legjislacionit në fuqi. Ofruesi i shërbimeve t’i trajtojë ato me respekt dhe dinjitet. Të jenë të mbrojtura nga të gjitha format e abuzimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i këtij standardi është i detyrueshëm, së bashku me përdorimin e një komunikimi miqësor ku të shmangët paragjykimi apo frika se personi që sapo është akomoduar mund të jetë burim infektimi. Sugjerohet të jepen të gjitha shpjegimet e duhura mbi rëndësinë e qëndimit në izolim për 14 ditë dhe të ofrohet kujdesi i nevojshëm duke zbatuar protokollin e mbrojtjes personale. Kjo

apo diskriminimit.

Standardi: Ofruesit e shërbimeve të nxisin dhe praktikojnë tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin pa bërë diskriminim mbështetur në racën, ngjyrën, kombësinë, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzëninë, të qenit prind, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, aftësitë e kufizuara, përkatësinë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera.

Standardi 4: Të dhënat personale të përfituesit dhe administrimi i tyre.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Të drejtat dhe interesat më të mira të përfitueseve të shërbimeve mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e institucionit për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.

Standardi: Ofruesit e shërbimeve të mbledhin dhe të ruajnë të dhënat personale të përfituesit duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të vëmendshme. Ofruesi i shërbimeve të krijojë kushtet në mënyrë që administrimi i të dhënave të bëhet në përputhje me normat ligjore dhe të mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.

është dhe përgjegjësi e mjekut të institucionit i cili bashkëpunon dhe me strukturat shëndetësore nga jashtë institucionit për të kontrolluar dhe vlerësuar situatën e përfitueseve në strehëz në përputhje me të gjithë masat e dhëna. Të bëhen përpjekje për një komunikim të shpeshtë përmes teleworking për të mbajtur nën kontroll situatën e saj si dhe për të filluar trajtimin e traumës së pësuar nga dhuna në familje. Në rast të terapisë të detyrueshme ballë për ballë, të respektohet detyrimisht ruajtja e distancës dhe vendosja e maskave dhe dorezave si nga terapistja edhe nga përfituesja e fëmijët e saj.

Zbatimi i këtij standardi mbetet i detyrueshëm,
- Konfidencialiteti i të dhënave të përfitueses (emri, mosha dhe fakti që është viktimë e DHBGJ e strehuar në një qendër rezidenciale publike ose jo-publike, mbetet detyrim për t'u ruajtur.

Kur bëhet njoftimi në nr.127 për të ndjekur një rast të dyshuar kujtoni rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit edhe të adresës së godinës së strehëzës.

- Dokumentacioni i UMPMM-së apo mbi kërkesën për UMM/UM, si dhe vendimet e gjykatës për vleftësimin e masave të UMPMM si edhe për lëshimin e UMM, vërtetimin e UMM, lëshimin e UM mund të quhet i plotësuar edhe nëse mbërrin vetëm në mënyrë elektronike tek strehëza (nga policia, gjykata, etj)

- Në strehëz duhet të krijohen të gjitha kushtet për pjesëmarrjen e përfitueses në një seancë gjyqësore të zhvilluar on-line (kur kjo e fundit është e mundur / lejohet/ kërkohet nga gjykata). Përdorimi i teleworking sugjerohet edhe për avokatet të cilat ndjekin çështjen gjyqësore të përfitueses. Kontaktimi mund të bëhet me telefon, video call, WhatsApp, Wiber, etj. Përfitueset mund të këshillohen në lidhje me përdorimin e teknologjisë për komunikimin me avokatet e tyre apo edhe psikologe të specializuara për COVID-19 për to dhe fëmijët

Nëse do të duhet që përfituesja të paraqitet në gjykatë dhe do të shoqërohet nga një punonjëse,

	duhet të zbatohen masat mbrojtëse dhe distancimi fizik.
<p>Standardi 5: Administrimi i brendshëm i qendrës së shërbimit</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përmes administrimit të brendshëm, ofruesit e shërbimeve të sigurojnë shërbim dhe funksionim eficient për të arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e praktikës më të mirë në terren.</p> <p>Standardi: Secili ofrues i shërbimeve të ketë mekanizmat e duhura formale të administrimit të brendshëm për funksionimin e qendrës dhe ekzekutimin e shërbimeve që ofron.</p>	<p>Zbatimi i këtij standardi është i detyrueshëm, duke përfshirë këtu edhe nevojën për rekrutim të vullnetarëve për ofrimin e shërbimit në strehëz, në rast se do të konsiderohet e domosdoshme. Njohja me këtë protokoll dhe atë të mbrojtjes personale e të godinës, është domosdoshmëri si për stafin ekzistues edhe për vullnetarët (nëse do bëhet pranim i tyre)</p> <p>Është e rëndësishme të nxitet të punuarit nga shtëpia për të gjitha ato shërbime që është e mundur (këshillimi ligjor, mbështetja emocionale dhe këshillimi psikologjik, etj)</p>
<p>Standardi 6: Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit.</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Stafi dhe përfituesit e shërbimeve të ndjehen të sigurt dhe jo të kërcënuar për jetën e tyre dhe të personave të tjerë në mjediset e ofruesit të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve i administron në kohë situatat emergjente në mjediset e tyre.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve të marrë masat për sigurinë e stafit të duhur dhe të përfituesve. Institucioni i ofruesit të shërbimeve të mbahet i paprekur dhe të ruhet fshehtësia e vendndodhjes së tij në çdo kohë. Çdo ofrues shërbimi të përcaktojë qartë mënyrat e trajtimit të situatave emergjente dhe të rreziqeve.</p>	<p>Ky standard zbatohet pa asnjë ndryshim nga çfarë është parashikuar për të.</p>
<p>Standardi 7: Monitorimi dhe vlerësimi</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Të garantohen shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara, për të rritur cilësinë e shërbimit të ofruar.</p>	<p>Ky standard zbatohet pa asnjë ndryshim nga çfarë është parashikuar për të.</p> <p>Gjithashtu duhet të bëhet monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve në kushtet e emergjencës për t'u përdorur më vonë si informacion bazë në planifikime për përballim të situatave të ngjashme të mundshme.</p>

Në tabelën në vijim paraqiten standardet e detyrueshme për t'u zbatuar nga strehëzat¹⁹ për viktimat e trafikimit, si dhe ndryshimet që ato pësojnë në bazë të këtij protokollit për emergjencën COVID-19

STANDARDI EKZISTUES	NDRYSHIMI / PËRSHTATJA QË PËSON
<p>Standardi 1: Qëllimi dhe llojet e shërbimeve</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Shërbimet e ofruara nga ofruesi i shërbimeve u përgjigjen nevojave individuale të përfituesit si viktimë trafikimi ose në rrezik trafikimi</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve ofron një paketë të plotë dhe efçente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në bashkëpunim me ofruesit primarë dhe alternativë, për të mundësuar mbrojtjen e personave në rrezik trafikimi, si dhe rehabilitim dhe ri integrim për ata të cilët janë tashmë viktima të trafikimit.</p>	<p>Zbatimi i këtij standardi mbetet i detyrueshëm siç është formuluar</p>
<p>Standardi 2: Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesit për përfituesen</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Nevojat e përfitueseve të shërbimeve të jenë vlerësuar plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës dhe nevojave të tyre, në funksion të hartimit të planeve individuale të përkujdesit.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve të hartojë një plan përkujdesi individual, në bashkëpunim me secilën përfituese të shërbimeve. Në plan të përshkruhen qartë nevojat e vlerësuara të përfituesit dhe veprimet që nevojiten për t'i zgjidhur ose përmbushur këto nevoja.</p>	<p>- Zbatimi i këtij standardi mbetet i detyrueshëm, por me kushtin që gjatë komunikimit, të ruhet distanca, si dhe të vihen maskat dhe dorashkat si nga punonjësja/punonjëset ashtu edhe nga përfituesja e re e sapo futur në strehëz, e cila qëndron në dhomë më vehte për 14 ditë.</p> <p>Plani i kujdesit afatgjatë mund të përfundohet pas periudhës së izolimit 14 ditor.</p>
<p>Standardi 3: Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitueseve</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përfitueset e shërbimeve t'i gëzojnë të gjitha të drejtat sipas legjislacionit në fuqi. Ofruesi i shërbimeve t'i trajtojë ato me respekt dhe dinjitet. Të jenë të mbrojtura nga të gjitha format e abuzimit</p>	<p>- Zbatimi i këtij standardi është i detyrueshëm, së bashku me përdorimin e një komunikimi miqësor ku të shmanget paragjykimi apo frika se personi që sapo është akomoduar mund të jetë burim infektimi. Sugjerohet të jepen të gjitha shpjegimet e duhura mbi rëndësinë e qëndimit në izolim për 14 ditë dhe të ofrohet kujdesi i nevojshëm duke zbatuar protokollin e mbrojtjes personale. Kjo</p>

¹⁹ Referohuni tek dokumenti i publikuar i standardeve në adresën: <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/VKM-nr.195-dt-11.04.2007.pdf>

<p>apo diskriminimit.</p> <p>Standardi: Ofruesit e shërbimeve nxisin dhe praktikojnë tolerancën, mirëkuptimin dhe respektin pa dallime, bazuar në përkatësinë gjinore, besimin, racën, origjinën, moshën, aftësinë mendore e fizike, bindjeve politike etj.</p>	<p>është dhe përgjegjësi e mjekut të institucionit i cili bashkëpunon dhe me strukturat shëndetësore nga jashtë institucionit për të kontrolluar dhe vlerësuar situatën e përfitueseve në strehëz në përputhje me të gjithë masat e dhëna. Të bëhen përpjekje për një komunikim të shpeshtë përmes teleworking për të mbajtur nën kontroll situatën e saj si dhe për të filluar trajtimin e traumës së pësuar. Në rast të terapisë të detyrueshme ballë për ballë, të respektohet detyrimisht ruajtja e distancës dhe vendosja e maskave dhe dorezave si nga terapistja edhe nga përfituesja e fëmijët e saj.</p>
<p>Standardi 4: Të dhënat personale të përfituesit dhe administrimi i tyre.</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Të drejtat dhe interesat më të mira të përfitueseve të shërbimeve mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e institucionit për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>Standardi: Ofruesit e shërbimeve të mbledhin dhe të ruajnë të dhënat personale të përfituesit duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të vëmendshme. Ofruesi i shërbimeve të krijojë kushtet në mënyrë që administrimi i të dhënave të bëhet në përputhje me normat ligjore dhe të mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.</p>	<p>Zbatimi i këtij standardi mbetet i detyrueshëm,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konfidencialiteti i të dhënave të përfitueses (emri, mosha dhe fakti që është viktimë e trafikimit e strehuar në një qendër rezidenciale publike ose jo-publike, mbetet detyrim për t'u ruajtur. Kur bëhet njoftimi në nr.127 për të ndjekur një rast të dyshuar kujtoni rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit edhe të adresës së godinës së strehëzës. - Dokumentacioni i për dosjen e përfitueses mund të quhet i plotësuar edhe nëse mbërrin vetëm në mënyrë elektronike tek strehëza (nga policia, gjykata, etj)
<p>Standardi 5: Administrimi i brendshëm i qendrës së shërbimit</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Nëpërmjet menaxhimit të brendshëm ofruesit e shërbimeve sigurojnë shërbim dhe funksionim eficient, duke arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e institucionit..</p> <p>Standardi: Çdo ofrues shërbimesh ka mekanizmat formalë të duhur të menaxhimit të brendshëm për funksionimin e institucionit dhe realizimin e shërbimeve që ofron</p>	<p>Zbatimi i këtij standardi është i detyrueshëm. Njohja me këtë protokoll dhe atë të mbrojtjes personale e të godinës, është domosdoshmëri si për stafin ekzistues edhe për vullnetarët (nëse do bëhet pranim i tyre)</p> <p>Është e rëndësishme të nxitet të punuarit nga shtëpia për të gjitha ato shërbime që është e mundu (këshillimi ligjor, mbështetja emocionale dhe këshillimi psikologjik, etj)</p>

<p>Standardi 6: Stafit dhe zhvillimi i tij</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Ofruesi shërbimeve garanton shërbime profesionale nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të të gjithë stafit dhe marrjes së masave për zhvillimin profesional të tyre.</p> <p>Standardi: Struktura, numri i punonjësve, arsimimi dhe aftësitë e tyre janë të përshtatshme për plotësimin e nevojave të përfituesve të shërbimit, që bën të mundur ruajtjen e cilësisë dhe efektivitetit në shërbimet e ofruara. Institucioni siguron trajnime dhe ngritjen e vazhdueshme profesionale të stafit të tij.</p>	<p>Ky standard zbatohet por me ndryshimin që në këtë periudhë trajnimet e planifikuara për stafin të mundësohen on-line.</p>
<p>Standardi 7: Siguria e përfituesve të shërbimeve dhe e stafit.</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Stafit dhe përfituesit e shërbimeve të ndjehen të sigurt dhe jo të kërcënuar për jetën e tyre dhe të personave të tjerë në mjediset e ofruesit të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve i administron në kohë situatat emergjente në mjediset e tyre.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimit merr masa lidhur me sigurinë e stafit të tij dhe të përfituesve. Në çdo kohë sigurohet paprekshmëria e institucionit të shërbimeve dhe ruhet fshehtësia e vendndodhjes së institucionit. Çdo ofrues shërbimesh ka të përcaktuar qartë mënyrat e përbaljes me situatat e emergjencës dhe të rrezikut.</p>	<p>Ky standard zbatohet pa asnjë ndryshim nga çfarë është parashikuar për të.</p>
<p>Standardi 8: Mjedi dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përfituesi i shërbimeve përfiton shërbime në kushte dhe në një mjedis të përshtatshëm.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve siguron kushte dhe mjedis të përshtatshëm për përfituesit dhe për stafin në përputhje me kapacitetin, karakterin e shërbimeve dhe nevojat e përfituesve</p>	<p>Ky standard zbatohet duke pasur parasysh edhe krijimin e dhomës së izolimit dhe respektimin e rregullave të paraqitura në seksionin 3 të këtij protokollit</p>
<p>Standardi 9: Bashkëpunimi në rrjet, veprime të koordinuara dhe partneritet me struktura dhe shërbime të tjera</p>	<p>Ky standard zbatohet duke marrë në konsideratë kufizimet, të punuarit on-line, etj siç u përshkruan në seksionet më sipër në këtë Protokoll.</p>

<p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përfituesi i shërbimit merr shërbime të shumëllojshme dhe në vazhdimësi në përgjigje të nevojave të tij/saj, falë bashkëpunimit të suksesshëm të ofruesit të shërbimit me aktorë të tjerë që operojnë në këtë fushë.</p> <p>Standardi: Nëpërmjet bashkëpunimit me aktorë të tjerë, ofruesit e shërbimeve sigurojnë ndjekjen e ecurisë dhe plotësimin e nevojave të përfituesit deri në riintegrimin e tij</p>	
<p>Standardi 10: Monitorimi dhe vlerësimi</p> <p>Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Të garantohen shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.</p> <p>Standardi: Ofruesi i shërbimeve të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara, për të rritur cilësinë e shërbimit të ofruar.</p>	<p>Ky standard zbatohet pa asnjë ndryshim nga çfarë është parashikuar për të.</p> <p>Gjithashtu duhet të bëhet monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve në kushtet e emergjencës për t'u përdorur më vonë si informacion bazë në planifikime për përballim të situatave të ngjashme të mundshme.</p>

Në tabelën në vijim përshkruhen standardet minimale të funksionimit të strehëzave sipas Konventës së Stambollit dhe përshtatja e tyre me situatën e emergjencës së pandemisë COVID-19

STANDARDET MINIMALE SIPAS KONVENTËS SË STAMBOLLIT	NDRYSHIMI / PËRSHTATJA QË PËSON
Shërbimet në strehëzat për gratë duhet të jepen nga staf gra	- E detyrueshme për zbatim, sidomos në kushtet e izolimit
Siguria e përfitueseve, duhet të adresohet përmes adresave të fshehta dhe masave të tjera të sigurisë	- E detyrueshme për zbatim. Për efekt të ruajtjes së sigurisë, së bashku me njoftimin në nr 127 për një person të dyshuar si të prekur me COVID-19 do të theksohet edhe detyrimi për ruajtjen e fshehtësisë së adresës së strehëzës.
Nëse nuk ka vende të mjaftueshme, apo nëse për arsye të caktuara strehëza mbyllet, duhet të marrë të gjitha masat paraprake të sigurojë vende të tjera të përshtatshme e të sigurta për të akomoduar banoret	- Në kushtet e emergjencës së pandemisë COVID-19 nuk rekomandohet mbyllja e shërbimit të strehimit të ofruar nga qendrat rezidenciale publike dhe jo publike. Nëse këto të fundit janë në krizë financiare dhe ndërkohë kanë përfituese të cilat po merrnin shërbim që përpara fillimit të emergjencës së COVID-19, duhet të njoftojnë menjëherë Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkinë, me qëllim t'u mundësohet kosto e

	vazhdimit të shërbimit, të paktën deri në përfundim të emergjencës së COVID-19.
Refuzimi për t'i dhënë shërbim apo për ta ripranuar një grua në strehëz duhet të ndodhë VETËM nëse ka thyerje serioze të rregullave të qëndrimit, të cilat dëmtojnë sigurinë e banoreve të tjera	- Në kushtet e emergjencës së pandemisë COVID-19 nuk rekomandohet refuzim i dhënies së shërbimit, sepse nëse sillet në strehëz nënkupton që kjo është e vetmja alternativë për shpëtimin e jetës së saj në rrezik. Por rekomandohet që rasti të mbahet nën kontroll duke marrë masa specifike në varësi të shkeljes që mund të ketë bërë më parë.
Mbështetja në strehëz duhet të jetë në dispozicion për aq kohë sa përfitueset kanë nevojë për të	- Mbështetja në strehëz për përfitueset që futen rishtazi, por edhe për ato që janë në përfundim të kohëzgjatjes së planifikuar për strehimin e tyre duhet të shtyhet deri në përfundim të situatës së emergjencës së COVID-19, edhe nëse nevoja e tyre për këtë shërbim përfundon më herët.
Numri i stafit duhet të jetë i mjaftueshëm që të sigurojë shërbimet e duhura për përfitueset dhe fëmijët	Në kushtet e emergjencës, numri i stafit pranohet të jetë edhe i reduktuar, mjafton që shërbimet bazë të domosdoshme të mos mbeten pa u ofruar. Ofrimi i shërbimeve përmes teleworking mbetet gjithashtu një mundësi
Mbështetja në situatë krize dhe plani i sigurisë duhet të hartohen individualisht për secilën përfituese. Informacioni mbi të drejtat dhe përgjegjësitë duhet t'i jepet përfitueses brenda 24 orëve nga momenti i pranimit. Rregullat duhet të formulohen me një gjuhë që nxit fuqizimin	Ky standard mbetet i zbatueshëm siç është i formuluar, me kushtin që si përfituesja edhe punonjëset të zbatojnë në mënyrë strikte protokollin e mbrojtjes dhe parandalimit të infektimit
Një raport i shkruar i vlerësimit të nevojave duhet të jetë gati brenda 3-7 ditëve nga momenti i pranimit. Ai duhet të përmbajë: nevojat shëndetësore, situatën në lidhje me fëmijët, nevojat për strehim afatgjatë, mundësitë për mbështetje ligjore, situatën financiare dhe mundësitë për mbështetje, trajnimin dhe edukimin	Në zbatim të këtij standardi, është e rëndësishme që në afatin e përcaktuar (3-7 ditore) të identifikohen dhe të përgatitet një raport vetëm për nevojat emergjente të përfituesets së sapostrehuar. Raporti mbi nevojat afatgjata mund të përgatitet pas përfundimit të periudhës 14 ditore të izolimit të saj
Srrehëza duhet të ketë mundësi të ofrojë (apo referojë në) shërbime mbështetëse, si shërbim ligjor, psikologjik, shoqërim në institucione, etj	Në kushtet e emergjencës për pandeminë e COVID-19, ofrimi i shërbimeve të tjera mbështetëse, apo referimi në këto shërbime të tjera mbështetëse, kur janë emergjente, rekomandohet të bëhet kryesisht nëpërmjet teleworking

<p>Strehëza duhet të ketë të paktën një staf të kualifikuar për trajtimin e fëmijëve</p>	<p>Në zbatim të këtij standardi, në mungesë të një specialisteje të kualifikuar për trajtimin e fëmijëve, Strehëza mund të koordinohet për marrjen e shërbimit të specializuar (mundësisht përmes teleworking) me Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe organizata të tjera të specializuara në ofrimin e këtij shërbimi</p>
<p>Mënyra e të punuarit në strehëz duhet të modelojë dhe nxisë respektin dhe mos përdorimin e dhunës ndërmjet të gjithë përfitueseve të rritura e fëmijë</p>	<p>Aplikimi i këtij standardi mbetet i detyrueshëm, pa ndryshime. Kujdes duhet bërë për të mundësuar komunikimin on-line dhe për të mos shkaktuar diskriminimin tek përfitueset të cilat nuk janë të orientuara mirë në përdorimin e teknologjisë. Gjithashtu kujtoni rregullin e shmangies së diskriminimit apo bullizmit për shkak të COVID-19</p>
<p>Kur nuk mund të ofrohet strehim për një rast për shkak të fëmijës djalë të rritur, duhet të mundësohet një tjetër alternativë e sigurt strehimi për të gjithë familjen</p>	<p>Në kuadër të zbatimit të këtij standardi, në strehëzën për viktimat e dhunës në familje lejohet strehimi i fëmijëve djem deri në moshën 18 vjeçare, por jo në strehëzën për viktimat e trafikimit. Megjithatë, në kushtet e emergjencës, strehimi i një nëne me fëmijën djalë mbi 14 vjeç do të ishte më i përshtatshëm në një banesë më vehte, për pagesën e qerasë së të cilës duhet të bëhet koordinimi me bashkinë, për ta përfshirë në mbështetjen ekonomike që ofrohet, të paktën deri në përfundimin e emergjencës së COVID-19 Për viktimat e trafikimit, është më e përshtatshme alternativa e vendosjes së familjes në apartament, banesë sociale se akomodimi në qender rezidenciale edhe në rastet e familjeve me fëmijë djem mbi 10 vjeç. Në qendrat rezidenciale për VT/VMT kur përfitueset janë vajza mbi 15 vjeç, është e papërshtatshme akomodimi i një nëne e cila është bashkë me fëmijën e saj djalë po të kësaj moshe apo më i madh se 15 vjeç.</p>
<p>Strehëza duhet të ofrojë mbështetje që siguron një pavarësi ekonomike të banoreve kur dalin nga strehëza</p>	<p>Ky standard mund të fillojë të zbatohet me përfundimin e periudhës së emergjencës, por jo aktualisht.</p>

5. ANEKSE

5.1. BAZA LIGJORE

- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale datë 24 Janar 2020 për “Përforcimin e përgatitjes për tu mbrojtur ndaj depertimit së koronavirusit të ri dhe parandalimit të përhapjes së tij në Shqipëri”
- Plani i Veprimit për Shqipërinë: “Parandalimi, përgatitja dhe përgjigja kundër COVID-19”, përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik
- Vendim i datës 08.03.2020 i Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga koronavirusi i ri
- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 157, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 243 datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”
- Akt Normativ i Këshillit të Ministrave Nr.8 datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar
- Akt Normativ i Këshillit të Ministrave Nr.9 datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, etj²⁰.

5.2. NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 TEK DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ GRAVE

Shqetësimi i ofrimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për vitkimat e dhunës në familje, në këto ditë të prballjes me pandeminë e COVID-19, është ngritur edhe nga organizatat ndërkombëtare. Kështu, Raporterja Speciale e UN mbi dhunën ndaj grave, Dubravka Simonovic²¹, thekson ndër të tjera në fjalën e saj në Gjenevë se: *“Të gjithë shtetet duhet të bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të adresuar kërcënimin COVID -19, por ata nuk duhet të lënë pas gratë dhe fëmijët viktime të dhunës në familje, sepse kjo situatë mund të çojë në rritjen e kësaj dhune, madje dhe deri në vrasjen e grave nga partneri intim. Situata agravon pikërisht në kohën kur nuk ka fare, ose kur ka vetëm një numër të vogël strehëzash dhe shërbimesh ndihmëse të disponueshme për viktimat; kur është e vështirë të qasesh në ato që janë akoma të hapura; dhe kur ka më pak mbështetje të komunitetit; më pak ndërhyrje policore dhe më pak qasje në drejtësi pasi shumë gjykata janë të mbyllura. Për shumë gra, masat emergjente të nevojshme për të luftuar COVID-19 kanë rritur ngarkesën e tyre në lidhje me punën në shtëpi dhe kujdesin për fëmijët, të afërmit e moshuar dhe anëtarët e familjes së sëmurë. Kufizimet e lëvizjes, kufizimet financiare dhe pasiguria e përgjithësuar i nxit autorët e dhunës, duke u dhënë më shumë pushtet dhe kontroll. Shqetësim më të madh përbëjnë grupe të caktuara të grave si: gratë me aftësi të kufizuara, gratë migrante apo azilkërkuese të pa pajisura me dokumenta dhe gratë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore. Prandaj dhe shtetet nuk duhet të lënë jashtë vëmendjes mbrojtjen e grave viktime të dhunës dhe duhet të vijojnë përpjekjet për të luftuar dhunën në familje edhe në kohën e pandemisë COVID-19. Masat për*

²⁰ Për më shumë referohu tek: <https://shendetesia.gov.al/masat-e-reja-per-te-parandaluar-perhapjen-e-covid-19/>

²¹ Shiko publikimin e datës 27 mars 2020 në:

<https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25749&LangID=E>

mbrojtjen e viktimave të dhunës duhet të mbeten të vlefshme duke u përshtatur me kushtet e krizës. Kjo nënkupton ksesin për të siguruar mbrojtje të menjëhershme përmes urdhërave mbrojtjës, si dhe mbajtjen hapur dhe funksionale të strehëzave dhe shërbimeve telefonike për viktimat. Edhe policia duhet të rrisë përpjekjet e saj për veprime të menjëhershme në situatë të dhunës në familje”.

Po kështu, Sekretarja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës, Marija Pejčinović Burić²² ka shprehur shqetësimin për një rritje të dhunës në familje gjatë kushteve të izolimit në shtëpi për shkak të COVID-19. Ajo thekson se raportet nga vendet anëtare tregojnë se gratë dhe fëmijët tani janë në rrezik më të madh abuzimi brenda shtëpive të tyre. Përveç rritjes së rrezikut të dhunës, efektet e krizës gjithashtu mund të dëmtojnë gratë ekonomikisht dhe të kërcënojnë pavarësinë e tyre financiare. Raportet nga Franca për shembull tregojnë se shumë gra nuk ishin në gjendje të telefononin në linjën telefonike të ndihmës, për shkak të kufizimeve. Ndërkohë që numrat e linjave telefonike të ndihmës kanë marrë katër herë më pak thirrje sesa normalisht, është rritur numri i mesazheve të menjëhershme për organizatat përkatëse të ndihmës në të gjithë Evropën. Kjo mund të nënkuptojë që autorët e dhunës nuk i lejojnë viktimat e tyre të kërkojnë ndihmë përmes telefonit. Në Danimarkë, është vërejtur se numri i grave që kërkojnë strehim në strehëzat e grave është rritur.

Studimet e deritanishme, bazuar dhe në eksperiencat nga përballja me pandemi të mëparshme, tregojnë se grupet më të rrezikuara²³ në këtë situatë të pandemisë së COVID-19 janë ata që për të siguruar jetesën varen shumë nga ekonomia informale, si dhe që kanë qasje të kufizuara në shërbime sociale apo në teknologji. Kështu, **fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, personat e infektuar apo që jetojnë me virusin HIV, personat me statusin e refugjatit, migrantit apo azilkërkuarit, të moshuarit, personat që aktualisht jetojnë në kushtet e një dëmtimi të mëparshëm të një situatë të emergjencës civile, personat nën mjekim të vazhdueshëm, minoritetet etnike apo personat LGBTI**, renditen ndër më të cënuarit në këtë situatë.

Që nga momenti i shpërthimit²⁴, COVID-19 ka infektuar qindra mijëra njerëz në të gjithë botën dhe ka krijuar një gamë të efekteve parësore dhe dytësore në individë dhe komunitete të ndryshme. Ekzistojnë disa mënyra në të cilat pandemia COVID-19 mund të ndikojë në dhunën ndaj grave dhe vajzave:

- **Rrezik i shtuar i dhunës në familje.** Në Kinë, raportet e policisë tregojnë se dhuna në familje është trefishuar gjatë epidemisë. Organizatat në mbrojtje nga dhuna në familje kanë vëzhguar rritjen e tensionit në familje dhe rritjen e icidenteve të dhunës në familje për shkak të bashkëjetesës së detyruar, stresit ekonomik dhe frikës për virusin. Përhapja e COVID-19 gjithashtu ka zvogëluar mundësinë e përdorimit të shërbimeve mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat e dhunës, veçanërisht në sektorin e shëndetit, policisë dhe drejtësisë. Ngjashmërisht rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje janë evidentuar edhe në Itali, Francë, Danimarkë, etj.

²² Shiko: <https://www.coe.int/en/web/portal/-/covid-19-crisis-secretary-general-concerned-about-increased-risk-of-domestic-violence>

²³ Përpunuar nga materiali i publikuar më 19 mars në: <https://interagencystandingcommittee.org/system/files/2020-03/COVID-19%20-%20How%20to%20include%20marginalized%20and%20vulnerable%20people%20in%20risk%20communication%20and%20community%20engagement.pdf>

²⁴ Përshtatur nga publikimi i datës 16 mars 2020 në: <http://www.sddirect.org.uk/media/1881/vawg-helpdesk-284-covid-19-and-vawg.pdf>

- **Rritje e rrezikut të dhunës në vendin e punës** në sektorin e shëndetit për shkak të stresit serioz që prek pandemia tek pacientët, të afërmit e tyre dhe punonjësit e tjerë të kujdesit shëndetësor. Në Kinë, ka pasur raporte për sulme fizike dhe verbale kundër punonjësve të kujdesit shëndetësor të vijës së parë. Në Itali, sindikata kombëtare e punëtorëve të kujdesit shëndetësor ka ngritur shqetësimin për sulmet kundër mjekëve dhe infermierëve pasi COVID-19 mposht burimet shëndetësore dhe familjet e pacientëve bëhen gjithnjë e më të shqetësuara. Në Singapor, punonjësit e kujdesit shëndetësor me uniformë janë ngacmuar në hapësira publike dhe transport. Ende nuk ka të dhëna për natyrën gjinore të dhunës, por hulumtimet para epidemisë zbuluan se shumica e dhunës i drejtohej infermiereve gra në departamentet e urgjencës me kohë të gjatë pritjeje, në vende të izoluara në shtëpitë e pacientëve, ose në departamente geriatrike ose psikiatrike.
- **Rritje e rrezikut të ngacmimit racor dhe seksual** (si në internet ashtu edhe jashtë tij). Raporte anekdotike të sulmeve të synuara seksuale ndaj grave jepen për Azinë Lindore. Për shembull, në Delhi, studentet vajza nga India verilindore u ngacmuan verbalisht, si dhe duke u gjuajtur me objekte në trup, ndërkohë që ngacmuesit u hodhën sende në pjesët e tyre private bërtisnin: “Ju zëntë koronavirusi!”
- **Rritje e rrezikut të abuzimit dhe shfrytëzimit për gratë punëtore në nevojë.** Në Shtetet e Bashkuara, ka pasur raporte për sjellje më shtrënguese dhe të dhunshme kundër punonjëseve të seksit me qendër në rrugë në Siatëll që prej fillimit të shpërthimit të COVID. Në Hong Kong, shoqata e punëtorëve migrantë ka paralajmëruar se punëtorët vendas (shumica prej të cilave janë gra migruese) janë detyruar të punojnë ditën e tyre të pushimit, që nga vendimi që njerëzit të qëndrojnë brenda.
- **Rritje e rrezikut të dhunës ndaj grave dhe vajzave në mjediset emergjente,** përfshirë kampe të refugjatëve dhe vendbanime ku gratë mund të jenë në rrezik të rritur nga forma të ndryshme të dhunës, përfshirë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin. Në ishullin Grek të Lesbos, organizatat e ndihmës raportojnë se gratë janë në rrezik të lartë të dhunës seksuale dhe tashmë kanë qasje të kufizuar në kujdesin shëndetësor. Disa organizata ndihmëse kanë pezulluar gjithashtu shërbimet për shkak të ngacmimit të punonjësve të ndihmës nga grupet lokale kundër migrantëve.
- **Rritje e rrezikut të shfrytëzimit seksual dhe dhunës nga punonjësit e shtetit dhe rojet e armatosura.** Kjo frikë është ngritur kryesisht në Kinë dhe Iran, por ende nuk ka të dhëna për dhunën me bazë gjinore të shtetit për shkak të pandemisë. Përvoja nga epidemitë e kaluara sugjeron rëndësinë e një qasjeje paralele, duke kombinuar mbështetjen e organizatave që punojnë drejtpërdrejt me të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe integrimin e çështjes së dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjigjet sektoriale (p.sh. shëndetësia, arsimi, mbrojtja e fëmijëve, siguria dhe drejtësia, mbrojtja sociale dhe krijimi i vendeve të punës).

Më poshtë jepet një përmbledhje e mësimave nga epidemitë e kaluara bazuar në shembuj nga shpërthimi i Ebola (në Afrikën Perëndimore), kolerës (në Jemen) dhe Zikës (në Karaibe, Amerikën Qendrore dhe Jugore)

MËSIMET E NXJERRA NGA PANDEMI TË TJERA TË NGJASHME ME COVID-19

<p>Sigurimi i mbështetjes për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Në epidemitë e kaluara, gratë dhe vajzat ishin në rrezik më të madh të përjetimit të formave të ndryshme të dhunës, ku format më të zakonshme ishin dhuna nga partneri intim, si dhe shfrytëzimi dhe abuzimi seksual. - Shërbimet mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ) kërkojnë në një nivel shumë më të madh gjatë urgjencave të shëndetit publik, por mbesin të kufizuar në disponueshmëri dhe fondet për to shpesh limitohen.
<p>Spektori shëndetësor</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të mbijetuarat e DHBGJ mund ta kenë të vështirë qasjen në kujdesin shëndetësor për shkak të kufizimeve në lëvizje dhe klinikave të mbyllura. - Frika nga dhuna dhe keqtrajtimi mund t'i parandalojë gratë të kërkojnë shërbime shëndetësore gjatë një epidemie. - Frika nga infeksioni mund të parandalojë njerëzit të hyjnë në shërbime shëndetësore gjatë një shpërthimi të epidemisë, duke përfshirë kujdesin për të shpëtuar jetën dhe mbështetjen për të mbijetuarat e DHBGJ. - Epidemitë mund të largojnë burimet e kujdesit shëndetësor larg shërbimeve për të mbijetuarat e DHBGJ, apo edhe shërbimeve mbi shëndetin seksual dhe riprodhues. - Janë ngritur shqetësime në lidhje me shfrytëzimin seksual nga punonjësit e shëndetit gjatë epidemive. - Mungesa e mbikëqyrjes kur prindërit apo kujdestarët janë shtruar në spital mund t'i vendosë vajzat dhe fëmijët adoleshentë në rrezik abuzimi dhe keqtrajtimi. - Ekzistojnë rreziqe në rritje të abuzimit, frikësimit dhe ngacmimit të punonjësve të kujdesit shëndetësor, veçanërisht të grave infermiere.
<p>Siguria dhe drejtësia</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Komunitetet raportojnë se frikësohen nga forcat e armatosura gjatë shpërthimeve të epidemive. Në vendet me kujtime të kohëve të fundit të konflikteve dhe dhunës seksuale kryer nga forcat e armatosura, angazhimi i shërbimeve të sigurisë gjatë një shpërthimi epidemie, mund të krijojë frikë dhe tension. - Ka pasur gjithashtu raportime të shfrytëzimit seksual nga punonjës të shtetit dhe anëtarët e komunitetit të ngarkuar me zbatimin e karantinës në nivelin e komunitetit.

	<ul style="list-style-type: none"> - Sistemet e policisë dhe drejtësisë mund të mbingarkohen gjatë një epidemie, duke krijuar një "atmosferë mosndëshkimi" ku rritet rreziku i DHBGJ-së.
Edukimi dhe mbrojtja e fëmijëve	<ul style="list-style-type: none"> - Masat e karantinës dhe stresi i lidhur me epidemitë mund të krijojnë tensione shtëpiake, duke çuar në rritje të frustrimit të prindërve dhe ndëshkime trupore. - Mbyllja e shkollës mund të rrisë rreziqet për vajzat adoleshente, për t'u ekspozuar ndaj formave të ndryshme të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit apo martesës së hershme. - Ekzistojnë gjithashtu rreziqe të rritura të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit që lidhen me të huajt që transportojnë mallra në komunitet dhe ofrojnë shërbime, të cilët mund të kërkojnë seks në këmbim të ndihmës ose përfitojnë nga mbikëqyrja në nivel të ulët e kujdestarëve. - Shpërthimet epidemike mund të krijojnë dhe intensifikojnë çështjet e mbrojtjes së fëmijëve për shkak se fëmijët të cilët ndahen nga prindërit apo kujdestarët, janë të stigmatizuar dhe kanë vështirësi në përdorimin e shërbimeve.
Mbrojtja sociale dhe krijimi i vendeve të punës	<ul style="list-style-type: none"> - Epidemitë kanë efekte të mëdha të menjëhershme ekonomike, si dhe efekte potencialisht afatgjata në aktivitetin ekonomik. - Ka pak prova, posaçërisht nga epidemitë, mbi nivelin e ndikimit të pasigurisë ekonomike në dhunën ndaj grave dhe vajzave. Sidoqoftë, ka prova se dhuna nga partneri intim dhe dhuna ndaj fëmijëve rriten gjatë kohës së stresit ekonomik. - Praktika premtuese nga epidemia e Ebola përfshin programe të transferimit të parave të cilat kanë elementë DHBGJ të integruar, siç është dhe trajnimi mbi DHBGJ dhe shfrytëzimin seksual për agjentët e parave të lëvizshme dhe partnerët e tjerë të shpërndarjes së të mirave materiale.
Mjediset humanitare	<ul style="list-style-type: none"> - Ekzistojnë pak prova të dokumentuara mbi ndikimin specifik të epidemive në DHBGJ në mjediset humanitare; megjithatë, dihet që shpesh ekzistojnë rreziku i rritjes së dhunës seksuale dhe dhunës nga partneri intim në situata të emergjencave civile. - Sidoqoftë, ka mësimet se si të sigurohen shërbime të menaxhimit të rasteve të DHBGJ edhe në zona të largëta, të cilat mund të jenë të zbatueshme gjatë epidemisë COVID-19

6. REFERENCA

- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale datë 24 Janar 2020 për “Përforcimin e përgatitjes për tu mbrojtur ndaj depertimit së koronavirusit të ri dhe parandalimit të përhapjes së tij në Shqipëri”
- Plani i Veprimit për Shqipërinë: “Parandalimi, përgatitja dhe përgjigja kundër COVID-19”, përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik
- Vendim i datës 08.03.2020 i Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga koronavirusi i ri
- Urdhër i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 157, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 243 datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”
- Akt Normativ i Këshillit të Ministrave Nr.8 datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar
- <http://www.ishp.gov.al/pyetje-dhe-pergjigje-te-shpeshta-virusi-dhe-semundja-nga-covid-19/>
- <https://endvaw.ca/wp-content/uploads/2020/03/PANDEMIC-PREPAREDNESS-.YWCA-NWT.pdf>
- <https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Botimi%20Standarted%202013.pdf>
- <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25749&LangID=E>
- <https://www.coe.int/en/web/portal/-/covid-19-crisis-secretary-general-concerned-about-increased-risk-of-domestic-violence>
- <https://interagencystandingcommittee.org/system/files/2020-03/COVID-19%20-%20How%20to%20include%20marginalized%20and%20vulnerable%20people%20in%20risk%20communication%20and%20community%20engagement.pdf>
- : <http://www.sddirect.org.uk/media/1881/vawg-helpdesk-284-covid-19-and-vawg.pdf>
- <https://shendetesia.gov.al/masat-e-reja-per-te-parandaluar-perhapjen-e-covid-19>
- <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/VKM-nr.195-dt.11.04.2007.pdf>